



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.623/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Arsim Hamzaj - kryesues, Kymete Kicaj dhe Skender Çoçaj - anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të parregullsive në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura më 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur me 04.03.2025, mori këtë:

V E N D I M

PRANOHEN të bazuara ankesat Anr.623/2025 e datës 01.03.2025 dhe ankesa Anr.630/2025 e datës 03.03.2025 të paraqitura nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosja, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me seli në Prishtinë, për shkak të parregullsive gjatë numërimit të votave në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 09.02.2025, ashtu që **URDHËROHET** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), respektivisht Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), që fletëvotimet me numër: VP/0104 (1 fletëvotim), VP/0207 (1 fletëvotim), VP/0205 (dy fletëvotime), VP/0106 (1 fletëvotim), VP/0406 (dy fletëvotime), VP/0804 (dy fletëvotime), VP/0503 (2 fletëvotime), VP/0410 (1 fletëvotim), VP/0501 (1 fletëvotim), VP/0401 (1 fletëvotim), VP/0703 (1 fletëvotim), dhe fletëvotimi me numër VP/18/06 (6 fletëvotime), të vlerësohen të vlefshme dhe të njëjtat të përfshihen në rezultatin përfundimtar.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 01.03.2025, ka pranuar ankesën Anr.623/2025 dhe ankesën Anr.630/2025 të cilën e ka pranuar me datë 03.03.2025 nga subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV). Në ankesën Anr.623/2025 pretendohet se më 28 shkurt 2025 dhe më 1 mars 2025, komisionerë dhe vëzhgues të Lëvizjes Vetëvendosje, kanë identifikuar se gjatë procesit të numërimit të

votave në Qendrën e Numërimit në Prishtinë fletëvotimet nga vendvotimet me numër: VP/0104 (1 fletëvotim), VP/0207 (1 fletëvotim), VP/0205 (dy fletëvotime), VP/0106 (1 fletëvotim), VP/0406 (dy fletëvotime), VP/0804 (dy fletëvotime), VP/0503 (2 fletëvotime), VP/0410 (1 fletëvotim), VP/0501 (1 fletëvotim), VP/0401 (1 fletëvotim), VP/0703 (1 fletëvotim), janë shpallur të pavlefshme për shkak të një gabimi teknik në shtypjet/printimet e fletëvotimeve përkatëse. Sipas parashtruesit të ankesës thekshet se konkretisht bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, votuesi duhet vet ta shtypë/printojë fletëvotimin nga faqja zyrtare e KQZ-së. Në fletëvotimet përkatëse, gjatë këtij procesi të printimit/ vërehet se fletëvotimet/ nuk janë printuar si të plota, ndonëse vërehet qartë qëllimi i votuesit. Më tutje në ankesë thekshet se sikur nga votuesi të kërkohej fillimisht të votojë e pastaj ta printojë/do të kishte kuptim supozimi se për kë ka votuar nëse fletëvotimi nuk është printuar komplet. Por meqë ky nuk është rasti dhe votuesi fillimisht ka printuar fletëvotimin në kushte shtëpie, e diktuar ndonjëherë nga formati i dërguar e specifikat krejt teknike e teknologjike, duhet të kihet parasysh qëllimi i votuesit ashtu siç e përcakton edhe Ligji. PZAP duhet të trajtojë situatat e votimit përmes postës, kushtet dhe rrethanat e shtypjes së fletëvotimeve cihe do të duhej të kishte parasysh qëllimin e votuesit gjatë plotësimit të fletëvotimit. E në rastet në fjalë është krejt e qartë që votuesi ka votuar pasi që ka printuar fletëvotimin dhe e ka pasur të qartë që fletëvotimi edhe në formën që është shtypur mjafton për ta shprehur vullnetin. I tërë procesi votimit ka qenë në rregull dhe në përputhje të plotë me dispozitat ligjore përkatëse. Pra me rastin e votimit, fletëvotimet i kanë plotësuar të gjitha kriteret të përcaktuara në Rregullën Zgjedhore nr. 12/2024. Pra, në fletëvotimet përkatëse, vërehet qartë qëllimi i votuesve se për cilin subjekt kanë votuar dhe shtypja/printimi jo i plotë, për arsyet e cekura më lartë, nuk mund ta cenojnë të drejtën e votuesit për të shprehur vullnetin e tyre përmes votimit ndaj subjektit përkatës. Në fund të fundit, po t'ia dërgonte KQZ fletëvotimet e shtypura përmes postës siç e ka edhe përgjegjësi, nuk do të kishim situata të tilla. Prandaj, nuk mund e nuk duhet të penalizohen votuesit për papërgjegjësinë e KQZ. Aq më tepër që në asnjë procedurë të KQZ-së nuk parashihet që fletëvotimet e tilla, janë të pavlefshme. Rrjedhimisht, fletëvotimet e tilla dhe veprimet e votuesve, janë përputhje të plotë me nenin 16 të Rregullores zgjedhore nr.12/2024 votimi, numërimi në vendvotim dhe menaxhimi i vendvotimit. Provë ka bashkangjitur Fletëvotimet përkatëse.

Ndërsa në ankesën Anr.630/2025, në të cilën pretendohet se më 3 mars 2025, komisionerë dhe vëzhgues të Lëvizjes Vetëvendosje, kane identifikuar se gjatë procesit të numërimit të votave në Qendrën e Numërimit në Prishtinë, fletëvotimet nga vendvotimi me numër: VP/18/06 (6 fletëvotim), ku (5 prej tyre), janë shpallur të pavlefshme për shkak të një gabimi teknik në shtypjet/printimet e fletëvotimeve përkatëse. poashtu një tjetër është shpallur e pavlefshme me arsyetimin se i mungon llogoja. Andaj sipas parashtruesit të ankesës thekshet se duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, votuesi duhet vet ta shtypë/printojë fletëvotimin nga faqja zyrtare e KQZ-së. Ashtu që në fletëvotimet përkatëse, gjatë këtij procesi të printimit/ vërehet se fletëvotimet/ nuk janë printuar si të plota, ndonëse vërehet qartë qëllimi i votuesit. Më tutje në ankesë thekshet se sikur nga votuesi të kërkohej fillimisht të votojë e pastaj ta printojë/do të kishte kuptim supozimi se për kë ka votuar nëse fletëvotimi nuk është printuar komplet. Por

meqë ky nuk është rasti dhe votuesi fillimisht ka printuar fletëvotimin në kushte shtëpie, e diktuar ndonjëherë nga formati i dërguar e specifikat krejt teknike e teknologjike, ashtu që duhet të kihet parasysh qëllimi i votuesit siç e përcakton edhe Ligji. Po ashtu në ankesë pretendojnë se PZAP duhet të trajtojë situatat e votimit përmes postës, kushtet dhe rrethanat e shtypjes së fletëvotimeve dhe do duhej të kishte parasysh qëllimin e votuesit gjatë plotësimit të fletëvotimit, ku në rastet në fjalë është krejt e qartë që votuesi ka votuar pasi që ka printuar fletëvotimin dhe e ka pasur të qartë që fletëvotimi edhe në formën që është shtypur mjafton për ta shprehur vullnetin. Andaj me rastin e votimit, fletëvotimet në fjalë i kanë plotësuar të gjitha kriteret të përcaktuara në Rregullën Zgjedhore Nr. 12/2024, si dhe në përputhje të plot me dispozitat ligjore përkatëse. Ashtu që në fletëvotimet përkatëse, vërehet qartë qëllimi i votuesve se për cilin subjekt kanë votuar andaj shtypja/printimi jo i plotë, për arsyet e lartë cekura, nuk mund ta cenonjë të drejtën e votuesit për të shprehur vullnetin e tyre përmes votimit ndaj subjektit përkatës. Më tutje në ankesë theksojnë se po t'ia dërgonte KQZ fletëvotimet e shtypura përmes postës siç e ka edhe përgjegjësi, nuk do të kishin situata të tilla, kështu që nuk mund dhe nuk duhet të penalizohen votuesit për papërgjegjësinë e KQZ. E aq më tepër që në asnjë procedurë të KQZ-së nuk parashihet që fletëvotimet e tilla, janë të pavlefshme. Andaj në ankesë pretendojnë se, fletëvotimet e tilla dhe veprimet e votuesve, janë në përputhje të plotë me nenin 16 të Rregullores zgjedhore nr.12/2024 votimi, numërimi në vendvotim dhe menaxhimi i vendvotimit. Provë ka bashkangjitur Fletëvotimet përkatëse.

Në përgjigjen e KQZ-së, të pranuar më datë 02.03.2025, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) pas shqyrtimit të ankesës dhe pretendimeve të palës ankuese thekson si në vijim: Bazuar në nenin 3 paragrafi 1.37 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, si dhe Procedurën e Qendrës së Numërimit dhe Rezultateve Zgjedhjet për Kuvendin e Republikës Kosovës - 9 shkurt 2025, e miratuar me vendimin e datës 25.02.2025, Nr.01/635/2025, Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR)- do të thotë lokacioni ku numërohen fletëvotimet me kusht (FK-të), fletëvotimet jashtë Kosovës, dhe çdo fletëvotim i rregullt siç kërkohet nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) apo Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashpresa, Në lidhje me vlefshmërinë e fletëvotimeve, neni 16, paragrafi 2 i Rregullores Zgjedhore Nr. 12/2024 2024 Votimi, Numërimi në Vendvotim dhe Menaxhimi i Vendvotimit, përcakton se një votë është e vlefshme kur është shënuar vetëm një subjekt politik dhe kuptohet qartë vullneti i votuesit. Në të kundërtën, vota konsiderohet e pavlefshme nëse: 1. Janë shënuar më shumë se një subjekt politik; 2. Nuk është shënuar asnjë subjekt politik; 3. Janë shënuar vetëm kandidatët, por jo subjekti politik; 4. Qëllimi i votuesit nuk është i qartë.

Gjatë numërimit të fletëvotimeve në QNR, vlefshmëria e fletëvotimeve dhe votave përcaktohet sipas nenit 16 të Rregullores Zgjedhore Nr.12/2024, e cila rregullon procesin e votimit, numërimit dhe menaxhimit të vendvotimit.

Bazuar në nenin 9 të Rregullores Zgjedhore Nr. 17/2024 për Votimin Jashtë Kosovës dhe Rregulloren Zgjedhore Nr. 12/2024 për Votimin, Numërimin dhe Menaxhimin e Vendvotimit,

procesi i printimit të fletëvotimit nga votuesit që votojnë përmes postës mbetet në diskrecionin e tyre. Votuesit jashtë Kosovës, të cilët kanë zgjedhur të votojnë me postë, mund të pajisen me fletëvotim në njërin nga mënyrat e mëposhtme: Përmes email-it, në adresën elektronike të dhënë gjatë aplikimit për regjistrim, ose duke e shkarkuar fletëvotimin nga ueb faqja zyrtare e KQZ-së, për ta printuar, plotësuar dhe dërguar me postë, brenda afateve dhe në përputhje me kriteret e përcaktuara. KQZ nuk lëshon një udhëzim të veçantë mbi mënyrën e printimit të fletëvotimit, pasi ky aspekt mbetet përgjegjësi e votuesit. Megjithatë, është thelbësore që fletëvotimi të plotësohet sipas dispozitave ligjore për të garantuar vlefshmërinë e tij gjatë procesit të numërimit dhe votuesi të shpreh vullnetin e tij. Gjithashtu, lidhur me çështje të ngjashme të ankimimit, ju rikujtojmë se PZAP ka marrë vendim në rastin A.nr.374/2019, të cilin e gjeni të bashkëngjitur. Në vijim, KQZ ju njofton se i gjithë materiali zgjedhor ndodhet në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) dhe është i disponueshëm për verifikim dhe hetim nga zyrtarët ePZAP.

Paneli, në kuptim të nenit 9 paragrafi 5, nën paragrafi 5.16 të Rregullores Nr.01/2024, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosijes së Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 84 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/1,-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ankesat e evidentuara me numrat si në vijim: A.nr.623/2025 dhe Anr.630/2025, janë bashkuar dhe janë trajtuar me një vendim, andaj procedimi i këtyre ankesave evidentohen nën shenjën e përbashkët A.nr.623/2025, për shkak të natyrës së njëjtë të çështjeve të parashtruara nga, nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje kundër Qendrës së Numërimit të Rezultateve në Prishtinë për shkeljen e njëjtë, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura të ankesave.

Ankesat janë të bazuara

Paneli i vlerësoi si të bazuara pretendimet e parashtruara në ankesë nga subjekti politik LVV, me të cilën pretendon se gjatë procesit të numërimit të votave Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) në Prishtinë, fletëvotimet me numër VP/0104 (1 fletëvotim), VP/0207 (1 fletëvotim), VP/0205 (dy fletëvotime), VP/0106 (1 fletëvotim), VP/0406 (dy fletëvotime), VP/0804 (dy fletëvotime), VP/0503 (2 fletëvotime, VP/0410 (1 fletëvotim), VP/0501 (1 fletëvotim), VP/0401 (1 fletëvotim), VP/0703 (1 fletëvotim), dhe fletëvotimi me numër VP/18/06 (6 fletëvotime), ku (5 prej tyre) janë shpallur si të pavlefshme nga QNR për shkak të një gabimi teknik në shtypjet/printimet e fletëvotimeve përkatëse. paneli i vlerësoi se janë të qëndrueshme, pasi që nga hetimi i kryer nga ana e Panelit janë vërtetuar të gjitha këto pretendime.

Paneli, me rastin e pranimit të ankesës, përgjigjes në ankesë, ka formuar ekipin hetues dhe ka dërguar në QNR, me datën 03.03.2025 për të zhvilluar hetime në raport me pretendimet e cekura nga ankuesi. Pas përfundimit të hetimit në QNR, Paneli ka gjetur se me rastin e ekzaminimeve ka rezultuar i qëndrueshëm pretendimi ankimor, sepse ato fletëvotime nuk mund të llogariten të

pavlefshme për shkak se të njëjtat janë të plota, qëllimi i votuesit vërehet qartë, në fletëvotime është votuar vetëm një subjekt politik dhe fletëvotimet janë plotësuar sipas rregullave të votimit si dhe sipas dispozitave të cituara.

Andaj nga kjo gjendje faktike, Paneli ka vlerësuar se nga ana e Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), këto fletëvotime gabimisht janë shpallur të pavlefshme, pasi që përkundër se të njëjtat kanë qenë të printuara jo në tërësi (pasi që u mungon rreshti i fundit), dhe për të njëjtat nuk mbajnë përgjegjësi votuesit, pasi që KQZ nuk ka paraparë udhëzim të veçantë mbi mënyrën e printimit të fletëvotimit, dhe ky aspekt ka mbetur përgjegjësi e votuesit, dhe për këto nuk mund të dëmtohen subjektet e caktuara, pasi që është ditur qëllimi i votuesit, se këto fletëvotime janë plotësuar sipas dispozitave ligjore të cilat garantojnë vlefshmërinë e tyre gjatë procesit të numërimit dhe votuesit kanë shprehur vullnetin e tyre, andaj paneli vlerëson se janë shpallur gabimisht të pavlefshme në kundërshtim me dispozitën ligjore nga neni 16 par.3 i rregullore Nr. 12.2024, për të cilën e urdhëroi KQZ-në, përkatësisht Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), që të njëjtat ti konsideroi si të vlefshme, ti rinumëroi dhe ti përfshijë në rezultat.

Bazuar në të lartcekurat, paneli duke u mbështetur në nenin 16 par.3 të Rregullores Zgjedhore Nr.12/2024, konstaton se votat konsiderohen të pavlefshme vetëm në rastet si në vijim: Votohet më shumë se një subjekt politik, nuk votohet asnjë subjekt politik, votohet vetëm kandidati e jo subjekti politik, dhe qëllimi i votuesit nuk është i qartë sipas procedurave të votimit dhe numërimit në vendvotim. Prandaj në rastin konkret këto fletëvotime të cilat janë shpallur të pavlefshme nuk hyjnë në kategorinë fletëvotimeve të pavlefshme siç e parashohin dispozitat ligjore e lartcekur, pasi që në rastin konkret në këto fletëvotime dihet qartë qëllimi i votuesit, pasi që është votuar një subjekt politik dhe kandidatët e saj.

ga të gjitha këto arsye e duke u bazuar në dispozitat e nenit 117 par. 4, lidhur me nenin 18 par. 1 të LZP-së, lidhur me nenin 13 par.10 nënpar.10.1 të Rregullores së PZAP-së (Nr.01/2024), u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr. 623/2025 më datën 04.03.2025

Kryesues i Panelit
Arsim Hamzaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.